REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:111828

Datë: 17.01.2020

Numri i dokumentit: 00766575

P.nr.3501/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, në përbërje me gjyqtarin e vetëm gjykues Alban Ajvazi, me Bashkëpunëtoren Profesionale Kristina Shtufi, në çështjen penale, kundër të akuzuarve: L.S. dhe E.G. për shkak se secili veç e veç kanë kryer veprën penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4832/2014, të datës 26.10.2015, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 18.12.2019, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit Edina Jupolli të akuzuarit: L.S. dhe E.G., të dëmtuarit L. H., D.A. dhe A. K., në datë 20.12.2019, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **17.01.2020**, përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

Të akuzuarit:

I. **L.S.**, nga i ati S. dhe nënë M., e gjinisë B., i lindur me datë ....., në Prishtinë, ku edhe jeton në rrugën "....., i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ....., shqiptarë Shtetas i Republikës së Kosovës.

II. **E.G.,** nga i ati Rr. dhe nënë Sh., e gjinisë Salihu, i lindur me datë ....., në fshatin M., Komuna e Prishtinës, ku edhe jeton, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ....., shqiptarë Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse

Me datë 29.06.2014, rreth orës 15:40, në Prishtinë, në rrugën "Bajram Bahtiri", pranë kafiterisë "K.", të pandehurit, duke përdorur forcë i kanë penguar personat zyrtar-policët A.K. L. H. dhe B. K., në kryerjen e detyrave zyrtare, ashtu që disa deri sa të dëmtuarit ishin duke arrestuar të dyshuarin I. S., të pandehurit i kanë penguar, në atë mënyrë që në momentin kur të dyshuarit I. ia kanë vënë prangat në njërën dorë, të pandehurit janë ngritur nga tavolina ku ishin duke pirë kafe në kafiterinë "K." , dhe e kanë tërhequr të dyshuarin I. duke e shkëputur nga policia dhe pamundësuar arrestimin e tij, deri sa ka arritur për asistencë një patrollë policore e kërkuar nga të dëmtuarit,

Me këtë secili veç e veç kanë kryer veprën penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 7,17,41,49,50,51,52 dhe 73 të KPRK-së, dhe neneve 365, të KPPK-së, të akuzuarit:

2019:111829

I G J Y K O N

Të akuzuarit: **L.S.,** me burg në kohëzgjatje prej **tre (3) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën verifikuese prej **një (1) viti**, nuk kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit: **E.G.,** me burg në kohëzgjatje prej **tre (3) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën verifikuese prej **një (1) viti**, nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari **L.S.** që ti paguaj shpenzimet e procedures dhe atë në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej **tridhjete** (**30) €,** si dhe në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave shumën prej **tridhjetë (30) €,** të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I akuzuari **E.G.** Lirohet nga shpenzimet e procedurës penale pasi që gjykatës i ka prezantuar Librezën e Asistencës Sociale ne Nr. DI.nr. 099, numri i regjistrit 47121 të dt: 22.06.2019

Të dëmtuarit: **L. H.** me adresë të vendbanimit Fsh S. K. Vushtrri, **D. A.** me adresë të vendbanimit "....." nr... Prishtinë dhe **A. K.,** me adresë të vendbanimit lagja "....."., ... në Gjilan udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregullt civilo - juridik.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP.II.nr.4832/2014, të datës 26.10.2015, i ka akuzuar: L.S. dhe E.G. për shkak se secili veç e veç kanë kryer veprën penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale kundër të akuzuarve, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 18.12.2019, dhe para leximit të aktakuzës Prokurori i Shtetit bëri ricilësimin e veprës penale sa i përket paragrafit të të njëjtit nen, ku në vend të veprës penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par 5 lidhur me par.1, duhet të jetë vepra penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par 2 lidhur me par.1, të KPRK-së,

I akuzuarit: L.S. para fillimit të shqyrtimir gjyqësor u deklaruan se e kanë kuptuar akuzën dhe e ndjejnë veten fajtor, kërkon nga gjykata që ti shqiptohet një dënim sa më i butë, dhe i premton gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale.

I akuzuari E.G. u deklaruan se e kanë kuptuar akuzën dhe e nuk e ndjejnë veten fajtor.

Gjyakta pas dëgjimit të dëmatuarit-dëshmitarët A. K., L.H. dhe D. A., i akuzuar pas dëgjimit të dëshmitarve kërkon nga gjykata që ti ipet mundësia e deklarimit lidhur me pranimin e fajsis.

I akuzuari E.G., deklaron se e ndien veten fajtor, kërkon nga gjykata që ti shqiptohet një dënim sa më i butë, pasi deklaron se është mbajtës i familjes, ka vajzën 9 muajsh, dhe i premton gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale si dhe njofton gjykatën që është shfrytëzues i ndihmës sociale ku gjykatës edhe ja ka dëshmuar me vërtetimin të cilin e ka të lëshuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale.

2019:111829

Prokurorja e Shtetit Edina Jupolli, në shqyrtimin gjyqësorë deklaroi se: pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, mbetet pran aktakuzës, konsideron se pranimi i fajësisë është mbështetur në provat materiale prova këto të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pasi ky pranim u bë në konform nenit 248 të KPP-së.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe deklarimit të prokurorit të shtetit, gjykata pasi u bind se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim u bë vullnetarisht, po ashtu ky pranim u mbështetë në faktet e çështjes që përmban aktakuza gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga të akuzuarit: L.S. dhe E.G., për veprën penale që i vihet në barrë, pasi që gjyqtari i vetëm gjykues u bind se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim u mbështetë edhe ne provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklarimet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve të lartcekur, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në hyrje të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe i shpalli fajtor të njëjtit pasi që më parë gjeti se penalisht janë përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë nga ana e tyre, pendimin, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të akuzuarit i shqipton dënim me kusht në bazë të nenit 51 të KPRK-së, me bindje se kjo është e mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me neneve 41 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesve sipas nenit 73 par 2 të KPRK-së, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Ky dënim është risocializim i të akuzuarve me anë të pezullimit të dënimit. Me anë të këtij dënimi kryesve u tërhiqet vërejtja seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryen vepër tjetër penale dënimi i suspenduar për një kohë të caktuar do të ekzekutohet.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.1, pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 dhe 4 të KPPK-së.

Vendimi për shumën e të hollave në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë konform nenit 39 par.3, nënpar.3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin për kërkesën pasurore juridike, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 463 par. 2 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

2019:111829

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2019:111828, 17.01.2020

G j y q t a r i

_____

Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.